



REPUBLIKA E KOSOVËS



KOMUNA E ISTOGUT

KONTRATË PËR PUNË

KOMUNA E ISTOGUT në vazhdim "*Njësia e Prokurimit*", të cilën e përfaqëson znj, *Zizë Bujupaj*, menaxhere e Prokurimit, Rruga "*Fadil Ferati*" Nr. 121 në njërën anë;

Dhe

"TERMOMONTIMI" SHPK nga Prishtina, të cilën e përfaqëson z. *Fatmir Mecinaj*, ne cilesinë e Menaxherit te Ndermarres me Nr. Rexh. Biznesi, 71144410 (ne vazhdim "*Kontraktuesit*"), ne anën tjetër, janë pajtuar te lidhin një kontratë publike për punë e shënuara me poshtë:

TITULLI I KONTRATËS:

NDËRTIMI I NDRIQIMIT PUBLIK NË GURRAKOC – LOT 3

Nr. I prokurimit	633-18-7251-52-1/C 169 - Lot 3
Nr. I brendshëm	633 / 018 / 071/ 521.

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kontratës është ekzekutimi i punëve në vijim nga ana e Kontraktuesit:

NDËRTIMI I NDRIQIMIT PUBLIK NË GURRAKOC

Neni 2 Çmimi

2.1 Çmimi total i punëve për aktivitetin e prokurimit **NDËRTIMI I NDRIQIMIT PUBLIK NË GURRAKOC** është: 16.534,55 € dhe me fjalë: /Gjashtëmbëdhjetë mijë e pesëqind e tridhjetë e katër euro 55/100 €

2.2 Çmimi i përmendur në Nenin 2.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Kontraktuesit sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve përgjatë ekzekutimit të kontratës.

2.3 Pagesat do të bëhen në pajtim me Kushtet e përgjithshme dhe/ose të Veçanta të kontratës.

Neni 3 Rendi i përparësisë i dokumenteve të kontratës

3.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

Marrëveshja e kontratës;
Kushtet e Veçanta të Kontratës;
Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
Tenderi i Kontraktuesit, duke përfshirë edhe Specifikimet Teknike;
Oferta financiare (Paramasa dhe Paralogaria);
Plani për menaxhimin e kontratës
Procesverbalet e Vizitës në teren e mbikqyesi

3.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

Neni 4 Komunikimet

4.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Kontraktuesit nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të dërgohen me postë, faks, email ose të dorëzohen personalisht. Komunikimet për Autoritetin Kontraktues mund të adresohen Autoritetit Kontraktues ose Menaxherit të Projektit i emëruar në Kushtet e Veçanta të Kontratës.

4.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimit të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për


pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimin të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.

4.3 Kudo në kontratë parashikohet për dhënien e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftim të tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njofton", "vërtetojë", "miratoj" ose "vendosë" do të interpretohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendim i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye.

4.4 Kjo kontratë është e përgatitur në gjuhën shqipe në tri origjinale, dy prej të cilave janë për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinale për Kontraktuesin.

Për Autoritetin Kontraktues:
Komuna e Istogut

Për Kontraktuesin:
"Termomontimi" Shpk

Emri:	Zizë Bujupaj	Emri:	Fatmir Mecinaj
Pozita:	Zyrtar Përgjrgjës i Prokurimit	Pozita:	Menaxher
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:	30.11.2018	Data:	30.11.2018
Vula		Vula	

PJESA III E KONTRATES kushtet e veçanta

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

[Udhëzimet për plotësimin e KVK janë dhënë, sipas nevojës, në shënimet kursive të përmendura për nenet përkatëse të KPK. Fshini ato jo relevante]

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
Përshkrimi i nenit	Neni. Nr.	
Ligji zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë gjuha SHQIPE
Përgjegjësia dhe Sigurimi i Kontraktuesit	7.2	Shuma minimale e sigurimit do të jetë: sipas Ligjeve në fuqi që rregullojnë lemin e siguracioneve.
Programi	8.1	Kontraktuesi do ta dorëzoj për aprovim Programin për Punët brenda 3. ditëve nga data e nënshkrimit të kontratës.
Siguria e ekzekutimit	10	Shume e sigurisë së ekzekutimit është: 10% e shumës totale të kontratës, në një afat prej 90 ditësh
Fillimi i punëve	17.1	Data e fillimit do të jetë menjëherë, pas nënshkrimit të kontratës, gjegjësisht me datë kur menaxheri i kontratës e përcakton në ditarin e punës dhe Librin ndertimor si dhe PLANIN PER MENAXHIM TE KONTRATES
Përfundimi i punimeve	17.2	Data e përfundimit e të gjitha Punëve dhe furnizimeve do të jetë: 60 ditë kalendarike, nga data e nënshkrimit të kontratës.
Dëmet likuiduara	e	Dëmet e likuiduara për të gjitha Punët janë llogaritura për ditë dhe atë 0.25 % për ç'do ditë vonese të paarsyeshme. Shuma maksimale e dëmeve të likuiduara për të

	19.1	<i>gjitha Punët është 10 % e çmimit final të Kontratës.</i> <i>Në qoftë se kontraktori nuk i kryen punimet në afatin e paraparë me kontratë, pa fajin e tijë, menaxheri i projektit duhet arsyetuar vonesen dhe shkaqet të cilat e kanë vonuar dinamikën e punimeve.</i>
<i>Inspektimi dhe testimi</i>	22.1	<i>Mbikqyrësi i kontratës caktohet z. Rasim Mahmutoviq, i cili do të kujdeset për rrjedhën dhe implementimin e kontratës deri në përfundimin e plotë të sajë.</i>
<i>Pagesat</i>	24.1	<i>Pagesat do të bëhen në euro ashtu si raporton Organi Mbikqyrës bazuar në raportin e mbikqyrësit, pas kryerjes së punimeve për situacionet përkatëse.</i>
<i>Përmirësimi i defekteve</i>	31.1	<i>Periudha garantuere e defekteve është 365 ditë, pas përfundimit të punimeve, bazuar në deklaratën e kontraktorit.</i>
<i>Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve</i>	42.1	KOMISIONI RREGULLATIV I PROKURIMIT PUBLIK
<i>Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore</i>	43.1	<i>a) Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të jetë Arbitrazhi – pranë Odes Ekonomike Prishtinë.</i>